



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjeto/Prodato Received/Delivery	20.03.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMBICK	2807/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.407/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.407/2023 të datës 23.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ h. Ballancë Komuna e Vitisë, kundër organit të punësimit Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.407/2023 e datës 23.02.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____ i punësuar në Komunën e Vitisë, përmes e-mailit ankesa.kpmschk@rks-gov.net më datë 23.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2014/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos përgjigjes nga organi i punësimit Komuna e Vitisë lidhur me kërkesën e ankuesit për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive nga data 01.12.2011 kur e ka nënshkruar Akt Emërimit e deri me datë 30.10.2022, konkretisht diferencës së një koeficienti të pagës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, komfor dispozitive Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 28.02.2023 me numër protokollit 2190/2023 ankesën e ankuesit e ka dërguar për përgjigje në ankesë në Komunën e Vitisë. Ndërsa Këshilli më datë 06.03.2023 me numër protokollit 2382/2023 përmes e-mailit ankesa.kpmschk@rks-gov.net ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokolli 2014/2023 të datës 23.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mail nga M.S. për ankesa.kpmschk@rks-gov.net i datës 23.02.2023; Kërkesë e ankuesit drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e datës 22.02.2023; Akt Emërim i M.S. me numër AE. Nr. 127/2022 i datës 11.11.2022; Akt Emërim i M.S. me numër 03-112/2363 i datës 30.12.2011; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 6890/2022 i datës 08.11.2022; Letërnjoftim i M.S.; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2190/2023 i datës 28.02.2023; E-mail nga H.Y. për ankesa.kpmschk@rks-gov.net i datës 06.03.2023 me numër protokolli 2382/2023; Përshkrimi i detyrave të punës; Listë e pagave e datës 01.08.2013; Vendim i Komisionit Komunal për ankesa dhe parashtrësia për shërbyesit civil në Komunën e Vitisë me numër protokolli 02-320/04-24783 i datës 29.05.2019; Lista e pagave e datës 01.02.2023 deri 28.02.2023; Lista e pagave e datës 01.01.2023 deri 31.01.2023; Lista e pagave e datës 01.03.2022 deri 31.03.2022; Kërkesë për pagesë retroaktive e datës 09.12.2022; E-mail nga H.Y. për C.Z. i datës 15.03.2023; E-mail nga C.Z. për H.Y. i datës 15.03.2023;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Komunën e Vitisë në pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës së Regjistrimit Civil". I njëjti më datë 26.09.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për kompensimin e pagës respektivisht diferencën e koeficientit nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë (8) sepse sipas Akt Emërimit të datës 30.12.2011 ankuesi e kishte koeficientin tetë (8), ndërsa bazuar në shkresën e DASHC/MAP-04/157102 ZSP/3851 të datës 20.11.2014 ankuesi thekson faktin se pozita të cilën mbanë duhet të harmonizohet dhe të paguhet me koeficientin tetë pikë pesë (8.5). Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.825/2022 të datës 08.11.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5), ku si rrjedhojë organi i punësimit respektivisht Komuna e Vitisë, më datë 11.11.2022 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimin AE.Nr.127/2022 me koeficient tetë pikë pesë (8.5).

Ankuesi më datë 09.12.2022 ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Vitisë dhe Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit për periudhën nga data 01.12.2011 kur e ka nënshkruar Akt Emërimin e deri me datë 30.10.2022. Ndërsa duke u bazuar në e-mailin zyrtar të Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë lidhur me kërkesën e ankuesit i njëjti na ka njoftuar se kërkesa e ankuesit nuk është realizuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

I pakënaqur kundër mos përgjigjes nga organi i punësimit, ankuesi me datë 23.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive nga data 01.12.2011 kur e ka nënshkruar Akt Emërimin e deri me datë 30.10.2022, konkretisht diferencës së një koeficienti të

pagës, sepse edhe përkundër se ne Akt Emërim e kishte pasur koeficientin tetë (8) ai ishte paguar me koeficient shtatë pikë pesë (7.5).

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, sepse sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 01.12.2011 ka nënshkruar pa vërejtje Aktin e Emërimit për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës së Regjistrimit Civil" me koeficient të pagës tetë (8), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit që qenë në djeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës dhe është paguar me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5) nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 09.12.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar Aktin e Emërimit me datë 01.12.2011), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: 130.1. *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.*

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.407/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

